



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-037

Prishtinë, më 8 tetor 2015, në orën 17:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Kujtim Paçaku.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Driton Lajçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Ismet Mahmuti.

Nga Zyra e Presidentes: Amir Haradinaj,

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancë plenare,
2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Përgatitjet për seancën plenare

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare lidhur me pikat e rendit të ditës (17), të gatshme për shqyrtim në seancë plenare.

Kryetari i GP të LDK-së, z. Ismet Beqiri, propozoi që pikat: 4, 5, 6, 9, 10 dhe 11 të shtyhen për seancën plenare tjetër të radhës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të enjten, më 15 tetor 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin mendor,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
6. Përzgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.
8. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
9. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga komuniteti serb,
11. Propozimi i grupeve parlamentar për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

* * *

Kryetari i Kuvendit diskutoi për situatën e krijuar në Kuvend gjatë seancës plenare, të mbajtur më 8 tetor 2015, të cilën e bllokuan deputetët e grupeve parlamentare opozitare. Ai kërkoi që të funksionalizohet aparatura e kontrollit në hyrjen e ndërtesës së Kuvendit.

Lidhur me këtë çështje diskutuan: Xhavit Haliti, Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Adem Grabovci, kryetar i GP të PDK-së, dhe Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Procedimi i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me projektligjin e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për siguri në punë në veprimtarinë minerare, të hartuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji, në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

2. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, propozimin e lartshënuar e shtyu për mbledhjen e Kryesisë së radhës.

3. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 9 shtator 2015, për rishikimin e ndarjes së shtesave, të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës

Kryesia, pas diskutimit lidhur me vendimin e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Nëpunësit civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës kompensohen në bazë të nenit 3, paragrafi 3, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores për orarin e punës dhe kompensimet për nëpunësit civilë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, miratuar nga Kryesia e Kuvendit, më 2 prill 2013.

2. Kompensimi i nëpunësit civil të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në legjislacionin në fuqi, duhet të vazhdojë pa ndryshime.

4. Prokurimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia diskutoi lidhur me çështjen e prokurimit në Kuvendin e Kosovës, por vendimmarrjen e shtyu për mbledhjen e radhës.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 18:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*